



Tregu i Fundvitit

Rregullat e aplikimit për periudhën 2015/16

QËLLIMI

Tregu i Fundvitit, aktivitet ideuar dhe organizuar nga Komuna e Prishtinës në prag të festave të fundvitit ka për synim mbështetjen e bizneseve të vogla me ide kreative. Këto të fundit do të kenë rastin të bëjnë shitjen e produkteve ushqimore, suvenireve dhe kartolinave punëdore në periudhë prej një muaji në 20 shtëpiza të drurit të cilat do të vendosen në sheshin “Zahir Pajaziti”.

RREGULLAT E TREGUT TË FUNDVITIT

1) Vendi dhe orari i punës

Hapja e Tregut të Fundvitit do të bëhet me datë 07 dhjetor 2015 në sheshin “Zahir Pajaziti” ku do të qëndrojë hapur deri me 08 janar 2016. Gjatë këtyre 30 ditëve bizneset e përzgjedhura për shtëpiza lejohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna në të dielën duke filluar prej orës 09:00 deri në orën 23:00. Asnjë shitje nuk do të lejohet para orës 09:00 si dhe pas orës 23:00.

2) Kriteret e aplikimit

Përzgjedhja e bizneseve të cilat do të jenë pjesëmarrëse në Tregun e Fundvitit do të bëhet nga një komision i posaqëm formuar në Drejtorinë për Shërbime Publike pranë Komunës së Prishtinës. Pasi numri i shtëpizave do të jetë i limituar është bërë aplikimi i kriterëve si më poshtë në mënyrë që selektimi të jetë sa më adekuat:

- Bizneset do të aplikojnë për produkte të djathit, ushqimit të shpejtë, ushqimit vegetarian, produkte brumërash, pije të ngrohta, suvenire si dhe dhurata dhe kartolina punëdore me motive të festave të fundvitit;
- Bizneset aplikuese duhet të jenë të regjistruara në Administratën Tatimore të Kosovës si dhe të jenë pajisur me arkë fiskale;
- Bizneset duhet të kenë dëshmi të ushtrimit të veprimtarisë specifike për të cilën do të aplikojnë;

- Bizneset aplikuese duhet të jenë pajisur me mjete/vegla të përshtatshme pune për veprimtarinë të cilën do ta ushtrojnë në Tregun e Fundvitit;
- Bizneset të cilat dorëzojnë formën e aplikimit të parat që nga data e njoftimit, do të trajtohen me prioritet;
- Bizneset të cilat promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore do të trajtohen me prioritet.

3) Tarifa e shfrytëzimit të shtëpizës

Tarifat për shfrytëzimin e shtëpizave të tregut të fundvitit janë përcaktuar duke u bazuar në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike, ku pagesa aplikohet në bazë të hapësirës publike të cilën e zë një shtëpizë. Pra, bizneset e selektuara do të jenë të obliguara të paguajnë paraprakisht shumën prej **10.00 Euro për m²** për periudhë një mujore të shrytëzimit të shtëpizës në hapësirë publike.

4) Distribuimi i shtëpizave

Numri total i shtëpizave shfrytëzuese do të jetë 20 sosh. Produktet e djathit do të destinohen në 2 shtëpiza, ushqimi i shpejtë do të destinohet në 5 shtëpiza, ushqimi vegjetarian në 1 shtëpizë, produktet e brumërave në 4 shtëpiza, pijet e ngrohta në 4 shtëpiza, suvenirët në 2 shtëpiza, si dhe kartolinat punëdore në 2 shtëpiza.

5) Kodi mirësjelles dhe obligimet shtesë

Të gjitha bizneset janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfillt në mes tyre. Në mënyrë që ky bashkëpunim të jetësohet sa më mire, komuna e Prishtinës gjatë 30 ditëve të Tregut të Fundvitit ndalon rreptësisht aktet si më poshtë. Nëse bëhet kryerja e tyre sanksionimi do të jetë marrja e lejës për shtëpizë si dhe në asnjë mënyrë nuk do të bëhet kthimi i mjeteve të paguara për shfrytëzim të saj.

- Kryerjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme mbrenda zonave të zhvillimit të tregut;
- Abuzimin verbal ose fizik të personave të cilët përfaqësojnë bizneset shitëse konkurrese, si dhe të blerësve apo qytetarëve të tjerë kalimtarë;
- Shitjen e produkteve të cilat nuk janë paraparë të shiten në asnjërin prej shtëpizave;
- Obligohen të gjitha bizneset e përzgjedhura që pas përfundimit të orarit të punës ta pastrojnë shtëpizën e tyre dhe hapësirën rreth saj.